

Vendim nr. 147 datë 05.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 05.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (E) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ENIS VRAPI

OBJEKTI: Kundërshtimi i vendimit nr. 00-2022-1579, datë 06.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Enis Vrapì është arrestuar në flagrancë si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga neni 236, paragrafi 2, i Kodit Penal (*KP*).

2. Në vijim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i është drejtuar gjykatës me kërkesë për vleftësimin e ligjshëm të arrestimit të kërkuarit dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1286 akti, datë 03.06.2022, ka vendosur vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe ka caktuar masën e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, të parashikuar nga neni 234 i KPP-së. Ajo ka arsyetuar se në caktimin e masës së sigurimit ka mbajtur në konsideratë disa faktorë, sikurse gjendjen familjare të tij, nivelin e lartë arsimor, gjendjen e pastër gjyqësore, si dhe rrezikshmërinë e veprës penale dhe të autorit.

4. Edhe pse kërkuari ka paraqitur apel, vendimi është miratuar nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 542, datë 20.06.2022, e cila ka arsyetuar se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se kërkuari ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 236, paragrafi 2, i KP-së. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë ka çmuar drejt edhe rrethanat për caktimin e llojit të masës së sigurimit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuari.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1579, datë 06.12.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se megjithëse kërkuari ka marrë dënimin në datën 10.10.2022 mbi të metat e rekursit në drejtim të mosnënshkrimit të tij nga një mbrojtës, ai nuk e ka plotësuar atë, duke sjellë për pasojë papranueshmërinë e rekursit për shkak të mosplotësimit të kriterëve formale të tij. Po kështu, sipas tij, shkaqet e ngritura në rekurs nuk parashikohen nga neni 432 i KPP-së dhe se pjesa e pretendimeve që lidhen me mënyrën e vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

6. Në datën 15.05.2023 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimin nr. 00-2022-1579, datë 06.12.2022.

II

Pretendimet e kërkuarit

7. **Kërkuari**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta e jetës së familjes, pasi në vitin 2017, kur ka aplikuar për të marrë autorizimin e tretë për armën e gjahut, është ndjerë i dhunuar. Po kështu, ai ka kërkuar të mbrohet jeta e çdo shqiptari jashtë dhe brenda kufijve. Sipas tij, ai është shoqëruar në komisariat dhe për shkak se ka refuzuar prangat, është

mbajtur në izolim në kushte të vështira, ku nuk iu lejua komunikimi me mbrojtësin e zgjedhur sipas ligjit dhe ju tejkaluan afatet.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitit të kërkuarit lidhet drejtpërdrejt me iniciimin e një procesi kushtetues. Individidi, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, mund ta vërë në lëvizje Gjykatën për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton se kërkuari duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në çështjen objekt gjykimi, Kolegji konstaton se pavarësisht se kërkuari ka kundërshtuar vendimin nr. 00-2022-1579, datë 06.12.2022 të Gjykatës së Lartë, i cili ka pasur për objekt rekursin ndaj vendimmarrjes së gjykatave më të ulëta lidhur me vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal, në thelb, pretendimet e tij janë sintetike (të përpiluara me shkrim dore në vetëm një faqe), të paqarta dhe të formuluara në mënyrë të përgjithshme. Në përmbajtje të tyre, teksta mungojnë çështjet kushtetuese që lidhen me caktimin e masës së sigurimit - objekt i vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë - paraqiten fakte të hershme në kohë që nga viti 2017, që nuk lidhen me ngjarjen për të cilën është i dyshuar, kërkohet mbrojtja e jetës së çdo shqiptari jashtë dhe brenda kufijve, ndërsa një pjesë e pretendimeve lidhen me gjykimin në themel të akuzës - kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik, i cili nuk rezulton të jetë bërë përfundimtar.

10. Për sa më lart, Kolegji çmon se kërkesa është haptazi e pabazuar, ndaj nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31, 31/a, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.